

Dispozitat dhe rregullat e Udhëtimit

﴿ نزهة النظر في بيان أحكام السفر ﴾

[Shqip – Albanian – ألباني]

Dr. Najif b. Ahmed El Hamed

Përktheu : Driton Lekaj

2009 - 1430

islamhouse.com

﴿ نزهة النظر في بيان أحكام السفر ﴾

[شقپ – Albanian – ألباني]

نايف بن أحمد الحمد

ترجمة: دريتون ليكاي

2009 - 1430

islamhouse.com

Dispozitat dhe rregullat e udhëtimit në Islam

Falënderimi i takon vetëm Allahut dhe paqja e bekimi qofshin për atë që nuk ka peygamber pas tij.

E më pas: Duke pas parasysh ardhjen e pushimit të fund vitit dhe shumë njerëz janë përgatitur për të udhëtuar atëherë është e përshtatshme biseda rreth disa rregullave të lidhura me udhëtimin dhe udhëtarët. Do t'i përmend ato si një përkujtim për veten dhe vëllezërit e mi duke lutur Allahun e lartësuar të na jep sukses, prandaj, po them duke u mbështetur në Allahun e lartësuar:

▪ **Shkakut i emërimit të tij “Sefer” – udhëtim:**

Shkakut i emërimit të udhëtimit “Sefer” është ai shpalos fytyrat dhe moralet e njerëzve dhe shfaq atë çka është e fshehur prej tyre.¹ Dhe kjo është transmetuar nga Emiri i Besimtarëve – Umeri (Allahu qoftë i kënaqur me të).²

E gjen njeriun që e njeh me vite të gjata dhe nuk të shfaq prej moralit të tij vetëm anën pozitive. Ndërsa kur udhëton me të disa ditë dhe e sheh natën dhe ditën, gjatë ngrënies, pijes, gjumit dhe sjelljes së tij kur ja t'i shfaq disa çështje që nuk të gëzon njohja e tyre. Emiri i Besimtarëve Umeri (Allahu qoftë i kënaqur me të) kur dikush në praninë e tij dëshmonte për dikë, e pyeste atë që e lavdëronte: A ke udhëtuar me të?

Njëherë kanë dëshmuar dy dëshmitarë te ai e ju ka thënë: Unë nuk ju njoh por, s'ka gjë silleni dikë që ju njeh? Ata erdhën me një njeri e Omeri i tha: Si i njeh? I njoh si të mirë dhe besnikë. Atëherë, Omeri i tha: A ke qenë fqinj i tyre? Ai tha: Jo. Omeri i tha: A i ke shoqëruar në udhëtim sepse në udhëtim njerëzit shpalosin moralin e tyre? Ai tha: Jo. Atëherë Omeri tha: Ti nuk po i njihe këta dy, silleni dikë që ju njeh.” Këtë e transmeton El Ukajli në librin e tij

¹ Lisan El Arab: 4/368” dhe “El Xhami Li Ahlaki Rravi ve Adabis Sami: 2/242”)

² Hulasat El Bedr El Munir: 2/436).

“Et Terih”, Hatibi në librin e tij “Kifaje”, Bejhekiu në librin e tij “Es Sunen”. Ukajli e ka konsideruar të dobët dhe ka thënë: Nuk ka në libër ndonjë hadith që ka në zingjirin e tij të panjohur, më të mirë se sa ky hadith. Ndërsa Ebu Alij b. Seken e ka konsideruar të saktë.”¹

Sadaka b. Muhamed ka thënë: *“Thuhet se udhëtimi është peshoja e njerëzve.”*²

- Dispozita për udhëtimin

Udhëtimi ndahet në tri grupe për sa i përket dispozitave islame, e ato janë:

I pari: Udhëtimi për të kryer ndonjë adhurim.

Sikurse udhëtimi për kryerjen e Haxhit, Umres, Xhihadit, vizita e të afërmeve apo vizita e të sëmurit, e të ngjashme. Ebu Hurejre transmeton nga Pejgamberi (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të) se ka thënë:

*“Një person vizitoi një vëlla të vetin në një fshat tjetër e Allahu e dërgoi një melek t'i dilte në rrugë. Kur i erdhi atij e pyeti: Ku donë të shkosh? Ai tha: Dua ta vizitoj një vëlla timin në këtë fshat. Pastaj e pyeti: A shpreson ndonjë të mirë për vete nga ai? Ai tha: Jo. Vetëm se e kam dashur për Allahun e lartësuar. Meleku i tha: Unë jam i dërguari i Allahut te ti të njoftoj se Allahu të donë ashtu siç e donë ti atë për Allahun.”*³

E dyta: Udhëtimi për të bërë mëkat.

Si p.sh. udhëtimi për të bërë mëkate apo udhëtimi i gruas pa të afërmin e saj apo udhëtimi për vizitën e varrezave. Ebu Hurejre transmeton se Pejgamberi (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi

¹ Hulasatu El Bedril Munir: 2/437 dhe Telhis El Habir: 4/197.

² Transmeton Hatibi në librin e tij: El Xhami Li Ahlakir Rravi ve Adabis Sami me numër: 1730.

³ Muslimi me nr: 2567.

të) ka thënë: *“Nuk synohen për udhëtim vetëm se tri xhamia: Xhamia ime, Xhamia e Shenjtë (Qabeja) dhe Xhamia El Aksa.”*¹

Ibn Abbasi transmeton se e ka dëgjuar Pejgamberin (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të) duke mbajtur ligjëruar:

*“Mos të vetmohet një njeri me një grua vetëm nëse me ta është i afërmi (mahremi) i saj dhe mos të udhëtoj ndonjë grua vetëm se me të afërmin e saj.” Një njeri u ngrit dhe tha: O i Dërguar i Allahut: Gruaja ime ka dalë për ta kryer Haxhin ndërsa unë e kam regjistruar emrin për të shkuar në këtë betejë (e ka emërtuar). Atëherë Pejgamberi i tha: Nisu dhe kryeje Haxhin me gruan tënde.”*²

E treta: Udhëtim i lejuar:

Sikurse udhëtimi për tregti, shëtitje, turizëm të pastër, gjueti, etj. Imam Shafiu thotë:

**Largohu nga vatani për diçka të lartë
Dhe udhëto ngase në udhëtim janë pesë dobi
Largimi i mēzsisë dhe përfitimi i pasurisë
Si dhe përfitimi i dijes, virtyteve dhe shoqërisë së mirë.**³

Dhe thotë Urvetu b. Verd:

**Ec në tokën e Allahut dhe kërko begatinë
Jeton i pasur apo vdes me arsye.**⁴

¹ Buhariu me nr:1132 dhe Muslimi me nr: 1397.

² Muslimi me nr: 1341.

³ “Divani” i Imam Shafiu: 74, “Fejdul Kadir: 4/82”, “Jetimetud Dehr: 5/40”

⁴ Emthalul Hadith: 1/93.

- Lehtësimet e lejuara të udhëtimit (Er Rruhas)

Ebu Hurejre transmeton se Pejgamberi (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të) ka thënë:

“Udhëtimi është një pjesë e dënimit. E ndalon ndonjërin prej jush nga gjumi, ushqimi dhe pija e tij. Kur ta kryej dikush prej jush punën e tij le të ngutet për t’u kthyer te familja e tij.”

Imam Neveviu ka thënë:

“Kuptimi i tij është e pengon nga plotësimi i tij, ta shijojë atë ngase, ka vështirësi, lodhje, përballim me të ftohtin dhe të nxehtin, me të fshehtën, me frikën. Ndahet nga familja, shokët dhe përballet me jetë të vështirë.”²

Dhe ka thënë Ibn Haxheri – Allahu e mëshiroftë -:

“Udhëtimi është një copë e dënimit d.m.th. pjesë e tij, e për qëllim me dënimin është dhembja që rrjedh nga vështirësia për shkak që hipja dhe ecja gjatë udhëtimit nënkupton lënien e asaj që e ka njeriu traditë ... ‘Nehmetehu’ që ka ardhur në hadith d.m.th. nevojën e tij ... Në këtë hadith përfitojmë mospëlqimin e largimit nga familja pa nevojë dhe referimin që të ngutet me kthimin sidomos nëse ata që i ka lënë frikësohet se humbin në mos prezencën e tij. Kjo për shkak se qëndrimi mes familjes nënkupton mirëqenien e cila të ndihmon në përmirësimin e kësaj bote dhe tjetrës. Gjithashtu në qëndrim arrihen namazet me xhemat si dhe forca për adhurimin.”³

¹ Buhariu me nr: 2839 dhe Muslimi me nr: 1927.

² Sherhun Nevevijj ala Sahih Muslim: 13/70, Mirkatul Mefatih: 7/414.

³ Fet-hul Bari: 3/623, gjithashtu shiko: Umdetul Karijj: 10/138, “Tenvirul Havalik”: 2/249.

Imamul Haremejni është pyetur kur është ulur në pozitën e babait të tij, se pse udhëtimi ka qenë pjesë e dënimit? Është përgjigjur menjëherë: “Ngase përmban ndarjen nga të dashurit.”¹

Ibn Abdul Berri – Allahu e mëshiroftë - thotë:

“Në këtë hadith ka argument se të vonuarit e shumë nga familja pa nevojë dhe synim të fesë apo dynjasë nuk është mirë dhe nuk lejohet dhe ai që e ka përfunduar nevojën e tij duhet të ngutet që të kthehet te familja e tij të cilët i furnizon nga frika e asaj që e cakton Allahu te ta pas tij. Pejgamberi (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të) ka thënë:

*“I mjafton njeriut si mëkat t’i humb ata që i furnizon.”*²

Abdul Kadër b. Ebil Fet-h thotë:

**Nëse thuhet se në udhëtim ka pesë dobi
Po them edhe pesë me të cilat nuk krahasohet ndonjë sprovë
Humbja e pasurive dhe toleromi i vështirësive
Si dhe gajle, mërzi, dhe ndarja nga ata që i dua.**³

Duke pas parasysh vështirësitë gjatë udhëtimit Ligjvënësi i Urtë ia ka lejuar udhëtarit disa lehtësime duke ia ka lehtësuar një mori dispozitash, e prej tyre:

E para: Shkurtimi i namazeve me katër rekate ashtu që falen nga dy rekate. Allahu i lartësuar thotë:

“Kur të jeni në udhëtim e sipër, nuk është mëkat për ju të shkurtoni namazin, nëse frikësoheni se jobesimtarët do të ju sjellin ndonjë të keqe. Jobesimtarët janë armiq tuaj të hapët.” (En Nisa: 101).

Jala b. Umejje thotë: I kam thënë Umer b. Hattabit (Allahu qoftë i kënaqur me të): “... nuk është mëkat për ju të shkurtoni namazin, nëse frikësoheni se jobesimtarët do të ju sjellin ndonjë të keqe.” ndërsa tash njerëzit janë të sigurt? Ai më tha: Jam çuditur sikurse që je çuditur dhe e

¹ Sherhuz Zurkanij lil Muvetta: 4/506.

² Et Temhid: 22/36.

³ “Ed Dav El Lami: 4/295, “El Mevsuatush Shirije: 330

kam pyetur të Dërguarin e Allahut (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të) për këtë e më ka thënë: *“Sadakë (lëmoshë) të cilën ua ka ofruar Allahu prandaj pranoni sadakën prej Tij.”*¹

E dyta: Bashkimi mes dy namazeve:

Është synet për udhëtarin nëse lodhet gjatë udhëtimit të bashkojë mes namazit të drekës dhe ikindisë si dhe akshamit dhe Jacisë. Qoftë bashkim paraprak apo të mëvonshëm me këtë rast e vepron atë që është më e lehtë për të për shkak të hadithit që e ka transmetuar Abdullah b. Umeri (Allahu qoftë i kënaqur me të dytë) i cili thotë: *“E kam parë Pejgamberin (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të) kur ngutej gjatë udhëtimit e vononte namazin e Akshamit gjersa ta bashkonte atë me namazin e Jacisë.”*²

Enes b. Maliku (Allahu qoftë i kënaqur me të) ka thënë: *“Pejgamberi (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të) nëse udhëtonte para se të anonte dielli nga zeniti e vononte drekën deri në kohën e ikindisë e pastaj i bashkonte e nëse anonte dielli e falte drekën e pastaj nisej.”*³

Muadhi (Allahu qoftë i kënaqur me të) ka thënë: *“Kemi dalë me të Dërguarin e Allahut (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të) për në betejën e Tebukut e ai e falte drekën dhe ikindinë së bashku si dhe bashkonte mes akshamit dhe jaciës.”*⁴

E treta: Prishja e agjërimit gjatë Ramazanit.

Allahu i lartësuar ka thënë: “...” (El Bekare: 184).

Xhabir b. Abdil-lah (Allahu qoftë i kënaqur me të) ka thënë: *“Pejgamberi (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të) ka qenë*

¹ Muslimi me nr:686.

² Buhariu me nr: 1041 dhe Muslimi me nr: 703.

³ Buhariu me nr: 1060 dhe Muslimi me nr: 704

⁴ Muslimi me nr: 706.

në një udhëtim dhe e ka parë një njeri dhe njerëzit ishin mbledhur përreth tij dhe e kishin vendosë në hije dhe tha: Çka ka? Ata thanë: Një person është duke agjëruar. Pejgamberi (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të) tha: Nuk është prej mirësisë agjërimi në udhëtim.” (Muslimi me nr: 1115 dhe në një transmetim tjetër shtoi: Përmbajuni lehtësimeve të Allahut të cilat ua ka lejuar.)

E katërta: Zgjatimi i kohës për dhënie mes-h.

Shurejh b. Hani transmeton dhe thotë: Shkova te Aisheja (Allahu qoftë i kënaqur me të) ta pyes për mes-hun mbi meste? Ajo më tha: *“Pyete Alij b. Ebi Talibin ngase, ai udhëtonte me të Dërguarin e Allahut (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të). E pyetëm atë dhe na tha: Pejgamberi (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të) e ka përcaktuar kohëzgjatjen për dhënie mes-h tre natë e tre ditë për udhëtarin dhe një natë e një ditë për vendasin.”¹*

E pesta: Mos obligimi i namazit të Xhumasë për udhëtarin.

Ngase prej kushteve paraprake të Xhumasë është vend qëndrimi e udhëtarin nuk është vendas dhe nuk ka qenë prej udhëzimit të Pejgamberit (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të) ta falë xhumanë në udhëtimin e tij.

Ibn Umeri (Allahu qoftë i kënaqur me të dy) ka thënë: *“Udhëtarin nuk obligohet ta falë Xhumanë.”²*

Dhe thotë Ibn Tejmijje – Allahu e mëshiroftë - :

“Dhe nuk u ka falur në udhëtimet e tij namaz të Xhumasë duke mbajtur hytbe e pastaj të fal dy rekate por, ua falte ditën e Xhuma në udhëtim dy rekate sikurse namazi i tij ditëve tjera. Gjithashtu kur ua fali drekën dhe ikindinë në Arafat ua fali nga dy rekate sikurse namazi i tij ditëve të tjera dhe nuk ka transmetuar askush se ka

¹ Muslimi me nr: 276.

² Abdurr Rrezaku: 3/172 dhe Ibn Abdul Berri e ka treguar këtë si pajtim unanim (Ixhma). El Istidhkar: 2/36.

kënduar me zë ditën e Xhuma në udhëtim, as në Arafat e as në tjerat dhe as nuk është transmetuar se ka mbajtur hytbe në ditën e xhuma në udhëtim pos Arafatit. Me këtë është bërë e ditur se e saktë është ajo në të cilën janë të parët e ymetit dhe shumica e tyre duke filluar nga katër imamët dhe të tjerët se udhëtari nuk falë namaz të xhumasë.”¹

Nëse udhëtari e falë xhumanë me imamin atëherë nuk e bashkon me ikindinë ngase, ikindia në të vërtetë bashkohet me namazin e drekës dhe jo me atë të Xhumasë. Pastaj Xhumaja është namaz i pavarur dhe ka dispozita të posaçme: Ai është namaz që falet me zë ndërsa namazi i drekës pa zë, ai falet dy rekate ndërsa dreka katër rekate, para tij është hytbja ndërsa dreka nuk ka hytbe para saj, koha e saj fillon para se të anoj dielli nga zeniti ndërsa dreka pasi të anon dielli nga zeniti dhe dallime të tjera.²

E nëse falet me imamin dhe e bën nijet ta falë drekë të shkurtuar atëherë i lejohet ta bashkon me ikindinë.

E gjashta: Kryerja e namazeve vullnetare në mjetin bartës.

Udhëtarit i lejohet ta falë namazin e natës, vitrin, namazin e duhasë dhe nafilet e tjera brenda veturës gjatë udhëtimit me të kah do që të kthehet ajo për shkak të hadithit të Seid b. Jesarit që ka thënë:

“Isha duke ecur me Abdullah b. Umerin (Allahu qoftë i kënaqur me të dy) në rrugën e Mekës. E Seidi tha: Kur u frikësova se do të gdhinte agimi zbrita e fala vitrin dhe e arrita e Abdullah b. Umeri i tha: Ku ishe? I thashë: Iu frikësova daljes së agimit kështu që zbrita dhe e fala vitrin. Abdullahi tha: A nuk e ke shembull të mirë të Dërguarin e Allahut (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të) ? I thashë: Po, pasha Allahun. Atëherë tha: “Pejgamberi (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të) e falte vitrin hipur mbi devenë.”³

¹ El Fetava: 17/ 480.

² Shiko Esh Sherhul Mumti: 4/582.

³ Buhariu me nr: 954 dhe Muslimi me nr:700.

Ibn Umeri (Allahu qoftë i kënaqur me të dy) ka thënë:
*“Pejgamberi (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të) e falte namazin e natës gjatë udhëtimit mbi kafshën e tij bartëse kah do që kthehej ajo dhe sinjalizonte me shenja përveç namazeve farze si dhe e falte vitrin mbi kafshën e tij bartëse.”*¹

E shtata: Lënia e syneteve të rregullta (Sunen Err Rrevatib) përveç synetit të sabahut.

Nga Hafs b. Asim b. Umer b. Hattab transmetohet se ka thënë: E kam shoqëruar Ibn Umerin në rrugë për në Mekë, dhe: “Na e fali namazin e drekës dy rekate dhe pastaj u nis dhe u nisëm me të derisa erdhi te vendndodhja e kafshëve të tij dhe u ul, e ulëm me të. Rastisi që e ktheu shikimin nga vendi që ishim falur dhe i pa disa njerëz në këmbë dhe pyeti: Çka po bëjnë këta njerëz? I thash: Po falin nafile. E më tha: *“Po të falja nafile do ta plotësoja namazin tim. O djali i vëllait tim e kam shoqëruar Pejgamberin (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të) në udhëtim dhe nuk shtonte më tepër se dy rekate gjersa ka vdekur pastaj e kam shëruar Ebu Bekrin dhe nuk shtoi më tepër se dy rekate gjersa ka vdekur pastaj e kam shoqëruar Umerin i cili nuk shtoi më tepër se dy rekate gjersa ka vdekur, pastaj e kam shoqëruar Uthmanin i cili nuk shtoi më tepër se dy rekate gjersa ka vdekur e Allahu ka thënë: “Ju keni në të Dërguarin e Allahut shembullin më të mirë”.*²

Këto lejime qoftë në veprim apo në lënie duhet që udhëtari t’iu përmbahet për shkak të fjalës së të Dërguarit të Allahut (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të):

*“Përmbajuni lehtësimit të Allahut që ua ka lejuar.”*³

Si dhe për shkak të hadithit të Xhabirit dhe Ibn Umerit (Allahu qoftë i kënaqur me ta) që ka thënë:

¹ Buhariu me nr: 955 dhe Muslimi me nr:700.

² Muslimi me nr: 689.

³ Muslimi me nr: 1115.

“Allahu dëshiron që të shfrytëzohen lehtësimet e Tij sikurse që urren të veprohen ndalesat e Tij.” (Ahmedi me nr: 5866 Mundhiriu – Allahu e mëshiroftë ka thënë: Senedin e ka të saktë.)¹

Si dhe nga Ibn Abasi (Allahu qoftë i kënaqur me të) transmetohet se ka thënë: Thotë Pejgamberi (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të):

*“Allahu ka donë të shfrytëzohen lehtësimet e tij sikur që ka donë të veprohen obligimet e Tij.”*²

Shfrytëzimi i lehtësimeve është adhurim që e kanë anashkaluar shumë njerëz kështu që ia vështirësojnë vetes me lënien e tyre duke menduar se më mirë është të lihen përderisa më mirë dhe më e plotë dhe më shumë në shpërblim është pasimi i synetit të Dërguarit të Allahut (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të) qoftë në udhëtim apo vendbanim, qoftë për farzet apo për lehtësimet e lejuara.

Për këto lehtësime dijetarët i kanë përmendur tre kushte me të cilat lejohet shfrytëzimi i tyre, e ato janë:

E para: Që të jetë udhëtimi në distancë që lejon shkurtimin e namazit e ajo është katër Bured³ e që është e barabartë me tetë dhjetë e nëntë kilometra sipas mendimit të shumë dijetarëve.

Ata b. Ebi Rabah transmeton se Abdullah b. Umeri dhe Abdullah b. Abasi (Allahu qoftë i kënaqur me ata dy):

*“I falnin dy rekate, dy rekate dhe prishnin agjërimin kur kalon katër burud⁴ dhe më shumë.”*⁵

¹ Et Tergib vet Terhib: 2/87.

² Ibn Hibbani me numër: 354.

³ Shiko: Librin e Merveziut: “Hilaful Ulema:45”, “El Istidhkar: 2/232”, El Mugni: 2/46, “Fethul Bari: 2/566”.

⁴ Të cilët janë të barabartë me 16 fersehë apo 48 mile.

⁵ E transmeton Bejhekiu: 3/137

Është transmetuar nga Ibn Umeri ajo çka kundërshton transmetimin e mëparshëm ngase e ka shkurtuar namazin edhe nën distancën e lartpërmendur.

Dijetarët kanë mendime të ndryshme rreth distancës së shkurtimit, Ibn Tejmije thotë:

”Pejgamberi (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të) nuk e ka kufizuar udhëtimin me një distancë qoftë ajo berid apo diç tjetër dhe as nuk e ka përkufizuar me kohë.”¹

Në Sahihun e Muslimit transmetohet nga Jahja b. Jezid El Hunajj se ka thënë: E kam pyetur Enes b. Malikun për shkurtimin e namazit? E më ka thënë:

“Pejgamberi (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të) kur dilte sa një distancë prej tre mileve apo tre fersehëve² – Ka dyshuar Shube: transmetuesi i hadithit – i falte dy rekate.”³

E dyta: Ndarja nga vendqëndrimi.

Mendojnë shumë udhëtarë se nuk i lejohet të shfrytëzoj lehtësimet e lejuara gjersa nuk e kalon distancën e shkurtimit të namazit dhe kjo nuk është e saktë por, udhëtarit i lejohet të shfrytëzojë këto lehtësime kur të kalon ndërtesat e vendbanimit të tij. Enesi (Allahu qoftë i kënaqur me të) ka thënë:

“E kam falur drekën me të Dërguarin e Allahut (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të) në Medine katër rekate dhe namazin e ikindisë në Dhul Hulejfe dy rekate.”⁴

Dhe Alij b. Rebia El Esedijj ka thënë:

“Kam dalur me Aliun (Allahu qoftë i kënaqur me të) dhe ne e shikonim Kufen dhe ai i fali dy rekate e pastaj i fali edhe dy rekate

¹ El Fetava: 24/127.

² Një Fersehë - Distanca që arrin tre mile hashimite e një mile hashimite është e barabartë me 5760 m.

³ Me nr: 691.

⁴ Buhariu me nr: 1039

*dhe ai e shihte Kufen e i thamë atij: A nuk po i fal katër? Na tha jo: Përderisa nuk të hyjmë.*¹

E treta: Të mos jetë udhëtimi, udhëtim për të bërë mëkat sipas shumicës së dijetarëve.

Këto lehtësime janë të lejuara për atë që udhëtimin e ka për adhurim apo udhëtim të lejuar ndërsa mëkatari me udhëtimin e tij sikurse plaçkitësi nuk ka të drejtë t'i shfrytëzoj ato ngase këto lehtësime të lejuara nuk lidhen me mëkate e duke u nisur nga kjo atëherë mëkatari me arsyen e udhëtimin të tij nuk mund të shfrytëzon asnjë nga këto lehtësime.²

Gjithashtu t'i lejohet mëkatarit shfrytëzimi i lehtësimeve përmban në vete ndihmën e tij në mëkat e mëkatari nuk ndihmohet në mëkatin e tij.

¹ Buhariu e ka transmetuar 'Talikan' dhe e ka vazhduar Abdurr Rrezaku me numër: 4321 e Ibn haxheri thotë: Senedi i tij është i saktë. " Talikut Taglik:2/ 421.

² Shiko: "Sherhul Muhedheb: 2/223, "EIEshbah ven Nedhair i Sujutiut: 95.

Rregullat e udhëtimit

Udhëtimi ka disa rregulla disa janë para tij, disa gjatë tij ose pak para se të arrij ose pasi të arrij dhe rregullat pas kthimit kthimit, e prej tyre:

E para: Istihareja.

Është mirë për atë që dëshiron udhëtimin apo diç tjetër të rëndësishme të falë dy rekate dhe të lutet me lutjen e Istihares që është transmetuar në hadithin e Xhabirit (Allahu qoftë i kënaqur me të) i cili thotë:

“Pejgamberi (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të) na e mësonte Istiharen në të gjitha çështjet sikurse që na e mësonte një sure nga Kurani dhe thoshte: Nëse dikush dëshiron të bëjë diçka le të fal dy rekate nafile pastaj le të thotë:

O Zoti im, të kërkoj zgjedhje të së mirës me dijen tënde dhe të kërkoj forcë me fuqinë tënde dhe kërkoj prej mirësisë tënde të madhe. Ngase Ti ke mundësi e unë nuk kam mundësi, ti dinë dhe unë nuk di dhe Ti je ai që e dinë të fshehtat.

O Zoti im, nëse ti e din se kjo çështje (e emërton nevojën e tij) është e mirë për mua, për fenë time, jetën time dhe përfundimin e çështjes sime apo ka thënë: për të tashmen apo të ardhmen e çështjes sime, e cakto atë për mua dhe ma lehtëso e pastaj më jep bereqet në të.

E nëse e din se kjo çështje është e keqe për fenë time, jetën time dhe përfundimit e çështjes sime apo ka thënë: për të tashmen apo të ardhmen e çështjes sime e largo atë nga unë dhe më largo mua nga ajo dhe më cakto mua të mirën kudo që të jetë dhe më bën të kënaqur me të.”¹

Ibn Ebi Xhemre – Allahu e mëshiroftë - thotë :

¹ Buhariu me nr:1109

“Ky hadith është i përgjithshëm dhe nëpërmjet tij dëshirohet diçka e veçantë, ngase për vaxhibin (obligimin) dhe mustehabin (ajo që është e preferuar) nuk bëhet istihare për veprimin e tyre, dhe për haramin (të ndaluarën) dhe mekruhin (të papëlqyerën) nuk bëhet istihare për lënien e tyre, kështu që është kufizuar puna në mubahin (të lejuarën) dhe në mustehabin nëse dy çështje prej tij kanë mospajtim d.m.th. me cilin të filloi apo të përkufizohet në të.”

Ibn Haxheri ka komentuar:

“Istihareja hyn edhe në çështje të tjera sikur vaxhibi dhe mustehabi që kanë të drejtë zgjedhjeje apo në atë që ka kohë të zgjeruar për kryerjen e tij dhe i përfshinë përgjithësimin të çështjeve të mëdha apo të vogla, ngase sa çështje të vogla ndërtohen mbi to çështje të mëdha.”¹

Ajniu – Allahu e mëshiroftë - ka thënë:

“Në këtë hadith përmban të preferuarit e namazit të Istihares dhe lutjes së ardhur në transmetim për çështjet të cilat njeriu nuk e dinë se cila është më e qëlluar. Ndërsa çështjet të cilat dobia e tyre është e njohur sikurse adhurimet dhe veprat e mira nuk ka nevojë ta bëjë istiharen për to. Po ndoshta bën istihare për kryerjen e ndonjë adhurimi në një kohë të caktuar sikurse p.sh. Haxhi në këtë vit për shkak të mundësisë së daljes së armikut, paraqitjes së sprovës apo ngujimit nga kryerja e haxhit. Gjithashtu është mirë të bëjë istihare për ta ndaluar nga një e keqe dikë si p.sh. të jetë ky person rebel, tiran e i frikësohet me ndalimin e tij nga e keqja të ndodh ndonjë dëm i madh në nivel të përgjithshëm apo individual.”²

Ibn Kajjimi – Allahu e mëshiroftë – ka thënë:

“Me këtë lutje i Dërguari i Allahut (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të) ua ka zëvendësuar umetit të tij atë në të cilën kanë

¹ Fethul Bari: 11/184.

² Umdetul Kari: 7/224.

qenë njerëzit në kohën e injorancës prej trazimit të zogjve, të kërkuarit e fatit me anë të shortit e të ngjashme me këtë është ky shorti e të cilën e veprojnë vëllezërit e idhujtarëve që kërkojnë dijen e asaj që u është e caktuar në botën e gajbit (të së fshehtës) ... E kemi për qëllim të tregojmë se istihareja është mbështetje në Allahun dhe besim i tërë veprave të Ai, kërkimi i të mirës duke u mbështetur në fuqinë, dijen dhe zgjedhjen e Tij të mirë. E kjo është prej obligimeve të pajtimit me të si Zot. E që askush nuk e shijon shijen e imanit nëse nuk është kështoj. E nëse është i kënaqur me të caktuarën pas saj, atëherë kjo është shenjë e lumturisë së tij.”¹

E dyta: Pendimi.

Ajo është obligim për çdo mysliman dhe myslimane qoftë në vendqëndrim apo në udhëtim. Allahu i lartësuar thotë:

“Pendohuni të gjithë te All-llahu, o besimtarë, në mënyrë që të gjeni shpëtim.” (En Nurë: 31)

E treta: Larja e borxhit.

Shumë njerëz në këtë kohë marrin borxh dhe e rëndojnë veten me pasuri të shumta të marra borxh për të udhëtuar dhe shëtitur përderisa është obligim larja e borxhit dhe pastrimi i vetes prej tij. Çështja e borxhit dhe nën vlerësimi me larjen e tij është çështje e madhe kështu që myslimani duhet të mos merr borxh përveç për një punë që e kërkon atë.

Ndërsa shëtitja dhe turizmi nuk janë të domosdoshme që të merret borxh për të. Kështu që e gjen njeriu merr borxh pasuri të shumta për t’u shëtitur dhe për rehati dhe qëndron vite të tëra duke ia vështirësuar vetes dhe duke ia ngushtuar familjes së tij furnizimin për shkak të kësaj.

¹ Zadul Mead: 2/443 – 445.

I mençuri nuk merr pasuri nga të tjerët borxh vetëm për ndonjë nevojë. I Dërguari i Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin për të) thotë:

“Kush vdes dhe ka borxh atëherë nuk mbetet dinarë dhe dërhem për të shpague por, të mirat dhe të këqijat.”¹

Si dhe Abdullah b. Amri (Allahu qoftë i kënaqur me të dy) transmeton se Pejgamberi (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin për të) ka thënë:

“I falet shehidit çdo mëkat përveç borxhit.”²

Neveviu – Allahu e mëshiroftë – thotë:

“Ky hadith aludon për të gjitha obligimet ndaj njerëzve dhe se xhihadi e shehidllëku dhe veprat e tjera të mira nuk i shpaguejnë obligimet ndaj njerëzve por, i shpaguejnë obligimet ndaj Allahut të lartësuar”³

Ibn Abdul Berri ka thënë:

“Në këtë ka argument se veprat e mira të pranuar nuk shpaguejnë prej mëkateve vetëm se atë që është mes robit dhe Zotit të tij ndërsa pasojat e veprave të tij ndaj të tjerëve për to duhet patjetër Kisasi (ndëshkimi i merituar dhe i ndërsjellë)”⁴

Thevbani (Allahu qoftë i kënaqur me të) transmeton se i Dërguari i Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) ka thënë:

“Ai që në momentin kur shpirti ndahet nga trupi është i pastër nga tri gjëra do të hyjë në xhenet, e ato janë: Mendjemadhësia, borxhi dhe marrja pa leje nga plaçka e luftës (el Gulul)”⁵

E katërta: Udhëtari të i lë furnizim familjes së tij.

¹ Hakimi: 2/32 dhe e ka konsideruar të saktë.

² Muslimi me nr: 1886.

³ Sherhu Sahihi Muslim: 13/29, si dhe Ed-Dibaxh Ala Muslim: 4/477, Tenvirul Havalik: 1/307.

⁴ Et-Temhid: 23/232.

⁵ Ahmedi në librin e tij “El Musned” me numër: 22423 dhe Nesaiu në librin “Es Sunen El Kubra” me numër: 8764 dhe Hakimi në librin e tij “El Mustedrek” 2/34 dhe e ka llogaritur të saktë.

Furnizimi i gruas dhe fëmijëve është obligim për burrin dhe në këtë nuk ka mospajtim prandaj burrit nuk i lejohet të tregohet i pakujdesshëm në këtë. Është për tu çuditur nga disa udhëtarë të cilët nuk kujdesen vetëm se për veten e tyre sa që ndonjëri prej tyre udhëton për shëtitje dhe e harron apo e lë me qëllim këtë amanet të cilën e ka bartur e që është të drejtat e gruas dhe fëmijëve të tij. Ai nuk u lë atyre furnizim të mjaftueshëm gjatë kohës sa është në udhëtim por, i lë të nevojshëm dhe pastaj kërkojnë nga njerëzit. Sa që disa nga ata e shet arin e gruas së tij me të pa drejtë dhe me arrogancë që të udhëton ai dhe shokët e tij.

Abdullah b. Amri (Allahu qoftë i kënaqur me të dy) transmeton se Pejgamberi (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin për të) ka thënë: *“I mjafton njeriut si mëkat të humbasë atë që ka për obligim ta furnizojë.”*

E pesta: Që njeriu të mos udhëtoj i vetëm.

Ai që udhëton i vetëm sidomos në vendet në të cilat janë të përhapura çështjet e ndaluara e eksponon veten e tij për të rënë në to. Për këtë patjetër duhet njeriu të zgjedhë shoqërinë e tij që i ndihmon në respekt ndaj Allahut dhe e largon atë nga vendet e dyshimta dhe të ndaluara.

Abdullah b. Amri (Allahu qoftë i kënaqur me të dy) transmeton se Pejgamberi (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin për të) ka thënë: *“Udhëtari i vetëm është shejtan, dy udhëtarë janë dy shejtanë e tre udhëtarë janë udhëtarë.”* Transmeton Maliku me numër: 1764, Ahmedi me numër: 6748, Ebu Davudi me numër: 2607, Nesaiu në librin e tij “Es Sunen El Kubra” me numër 8849, dhe Hakimi: 2/212 e transmetimi i tij është kështu:

“Një njeri erdhi nga udhëtimi dhe i Dërguari i Allahut i tha: Kë e shoqërove? Ai tha: Nuk e kam shoqëruar askënd. Atëherë i Dërguari i Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin për të)

¹ Transmeton Ahmedi me numër: 6495, Ebu Davudi me numër: 1692, Nesaiu në librin e tij “Es Sunen El Kubra” me numër 9177 dhe e ka llogaritur të saktë Ibn Hibbani me numër: 4240 dhe Hakimi: 1/575.

tha: “ Udhëtari i vetëm është shejtan, dy udhëtarë janë dy shejtanë e tre udhëtarë, janë grup.”

E gjashta: Përshëndetja e familjes e sidomos prindërve.

Çdokush që dëshiron të udhëtoj duhet të kërkojë leje nga prindërit e tij e nëse i japin leje udhëton përndryshe e lë udhëtimin. Disa të rinj – Allahu i udhëzofte – të fundit që i lajmëron për udhëtimin e tij janë prindërit e tij e ndoshta nuk i lajmëron vetëm se disa ditë pasi të arrin në vendin që ka shkuar. Në anën tjetër e gjen se i ka lajmëruar shokët dhe kolegët e tij disa ditë më herët dhe ndoshta i pyet nëse kanë ndonjë punë apo nevojë për t’ua kryer në atë vend përderisa prindërit e tij janë të fundit që dinë për udhëtimin e tij. E kjo është një mospërfillje e ulët e të drejtave të prindërve.

Transmetohet nga Muavije b. Xhahime se Xhahime (Allahu qoftë i kënaqur me të) ka shkuar te i Dërguari i Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin për të) dhe i ka thënë:

“O i Dërguar i Allahut dua të dal në luftë por kam ardhur të këshillohem me ty? E Pejgamberi (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin për të) i tha: A e ke nënën? Ai i tha: Po. Atëherë Pejgamberi (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin për të) i tha: “Rri me të ngase xheneti është te këmba e saj.” Pastaj ia përsëriti për herë të dytë dhe të tretë, në vende të ndryshme, fjalë të ngjashme sikurse kjo fjalë.”

Abdullah b. Amri (Allahu qoftë i kënaqur me të dy) transmeton se: Një njeri erdhi te i Dërguari i Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin për të) të ia jepte besën dhe i tha:

“Kam ardhur të ta jap besën që të bëj hixhret (shpërngulem) te ti por, i kam lënë dy prindërit e mi duke qarë. E Pejgamberi (paqja

¹ Transmeton Ahmedi me numër: 15577, Nesaiu me numër: 3104, dhe Hakimi e ka llogaritur të saktë 4/167.

*dhe mëshira e Allahut qofshin për të) i tha: “Kthehu te ta dhe bëji ata të buzëqeshin ashtu sikur që i ke bërë të qajnë.”*¹

Ebu Seid El Hudrijj (Allahu qoftë i kënaqur me të) transmeton se një njeri nga Jemeni bëri hixhret te Pejgamberi (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin për të). E Pejgamberi (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin për të) e pyeti:

*“A e ke dikë në Jemen? Ai iu përgjigj: Po, të dy prindërit. Pejgamberi (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin për të) i tha: A të kanë lejuar të vish? Ai i tha jo. Atëherë Pejgamberi (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin për të) i tha: Kthehu te ta dhe kërkoju leje nëse të lejojnë atëherë na u bashkëngjit në luftë përndryshe përkujdesu ndaj tyre.”*²

Thotë Ibn Haxheri – Allahu e mëshiroftë -:

“ Ndalohet xhiahadi nëse ia ndalojnë këtë prindërit me kusht që të jenë myslimanë ngase përkujdesja ndaj tyre është obligim individual për të (fard ajn) ndërsa xhiadi është obligim kolektiv (fard kifaje). E nëse xhiahadi bëhet obligim individual atëherë nuk ka leje.”³

E nëse leja është e obliguar për Xhihadin i cili është kulmi i Islamit si është puna atëherë me një udhëtim shëtitjeje apo turizmi.

Ndërsa për mënyrën se si i përshëndet, Kazea thotë: Më ka thënë Ibn Umeri:

*“Eja të ta jap lamtumirën ashtu si më ka thënë i Dërguari i Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin për të): “Allahut ia lë në përkujdesje fenë tënde, amanetin dhe përfundimin e veprave tuaja.”*⁴

E shtata: Ta thotë lutjen e udhëtimit:

¹ (Transmeton Ahmedi me numër: 6490, Ebu Davudi me numër: 2528, Nesaiu me numër: 4163 dhe e ka konsideruar të saktë Ibn Hibbani me numër: 419 dhe Hakimi: 4/168)

² Transmeton Ebu Davudi me numër: 2530 dhe Ibn Hibbani me numër: 420 dhe e konsideron të saktë si dhe Hakimi: 2/114.

³ Fethul Bari: 6/140.

⁴ Transmeton Ahmedi me numër: 4781, Ebu Davudi me numër: 2600 dhe Nesaiu në “Es Sunen El Kubra” me numër: 10360 dhe hadithi ka edhe rrugë transmetimi të tjera.

E ajo është e cila është transmetuar në hadithin e Ibn Umerit (Allahu qoftë i kënaqur me të dy) se i Dërguari i Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin për të) kur drejtohej mbi devenë e tij dhe ishte duke u nisur për udhëtim merrte tekbir (Allahu Ekber) tre herë pastaj thoshte:

“I Lartë Madhëruar qoftë Ai që i nënshtroi këto për ne, sepse ne nuk do të kishim mundësi ta bënim këtë. Ne me të vërtetë te Zoti ynë do të kthehemi. O Zoti ynë, të lutemi që në udhëtimin tonë të na mundësosh të bëjmë mirës dhe të jemi të devotshëm, të bëjmë vepra me të cilat ti je i kënaqur. O Zoti ynë, na e lehtëso neve udhëtimin tonë dhe na e bëj të rehatshme rrugën. O Zoti ynë, Ti je shoqëruar në udhëtim dhe mbrojtës i familjes sonë. O Zoti im, kërkoj që të më mbrosh nga vështirësitë e udhëtimit, nga shikimet qëllimkëqija dhe nga telashet me pasuri dhe familje.” E kur kthehej i thoshte të njëjtat fjalë dhe shtonte: “U kthyem të penduar, të përkushtuar dhe Zotin tonë duke falënderuar.”¹

E teta: Të dal ditën e enjte.

Ngase është transmetuar nga Kab b. Maliku (Allahu qoftë i kënaqur me të) se:

“Pejgamberi (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin për të) ka dalë ditë e enjte për në betejën e Tebukut dhe kishte dëshirë të dilte për udhëtim ditën e enjte.”²

E nënta: Të merr tekbir nëse ngjitet lartë dhe të bën tesbih kur shkon teposhtë në ndonjë luginë.

Xhabiri (Allahu qoftë i kënaqur me të) transmeton se:

“Kur hipnim tatëpjetë merrnim tekbir ndërsa kur zbritnim bënim tesbih.”

¹ Muslimi me numër: 1342.

² Buhariu me numër: 2790.

E dhjeta: Të shtojë prej lutjeve gjatë udhëtimit.

Udhëtimi është një prej vendeve ku pranohen lutjet. E udhëtari duhet të shfrytëzojë këtë rast për tu lutur për veten e tij, prindërit, pasardhësit, të afërmit dhe myslimanët me një lutje e cila ndoshta përkon momentin e pranimit të lutjeve e fiton me këtë rast me të mirat e kësaj bote dhe ahiretit.

Ebu Hurejre (Allahu qoftë i kënaqur me të) transmeton se Pejgamberi (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin për të) ka thënë: *“Tri lutje janë të pranuar dhe për këtë nuk ka dyshim: Lutja e prindit, lutja e udhëtarit dhe lutja e atij që i është bërë padrejtësi.”*¹²

E njëmbëdhjeta: Nëse udhëtarët janë grup atëherë e zgjedhin një nga ata përgjegjës dhe e respektojnë përveç nëse i urdhëron në mëkat.

Ebu Seid El Hudrijj (Allahu qoftë i kënaqur me të) transmeton se i Dërguari i Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin për të) ka thënë: *“Nëse dalin tre vetë në udhëtim le të zgjedhin në mesin e tyre një emir (përgjegjës).”*¹³

Nuk ka dyshim se emërimi i ndonjërit prej tyre udhëheqës e pakëson mos pajtimin gjatë udhëtimit sidomos kur ka dëshira të ndryshme ku gjen ndonjërin prej tyre dëshiron të ndalet këtu ose atje e patjetër duhet të ketë udhëheqës që e largon mospajtimin.

E dymbëdhjeta: Të stolisurit me durim dhe virtyte të lavdëruara gjatë udhëtimit dhe jashtë tij.

**Nëse ti i shoqëron burrat bëhu si një djalë
Sikur të jesh rob i çdo shoqëruesi**

¹ Buhariu me numër: 2832 dhe e titulloi: Kaptina për tesbihun kur zbrit në ndonjë luginë dhe e titulloi në një vend tjetër: Kaptina për tekbin kur ngjitet në vende të larta.

² Ahmedi, nr.: 7501, Ebu Davudi, nr.: 1536 dhe Ibn Hibbani, nr.: 6629 dhe e ka llogaritur të saktë.

³ Ebu Davudi me nr. 2608, Neveviu në librin e tij “Rijadus Salihin” thotë: Senedi i tij është i mirë.

**Bëhu sikurse shija e ujit e kthjellë dhe e ftohtë
Për mëlçinë dhe meritë për çdo shok.¹**

Transmetohet nga Muadhi (Allahu qoftë i kënaqur me të) se ka thënë: “Udhëtoni me njerëzit që janë bujar dhe të pasur ngase udhëtimi i nxjerr në shesh fshehtësinë e natyrshmërisë dhe cilësitë e fshehta. Kur të lodhen trupat lodhen forcat që ndryshojnë në të paktë dhe të shumtë ngase natyrat i ngjallin dhe sqarojnë sasinë e tyre, shtimin e disa prej tyre dhe mangësinë e të tjerave. Kështu që shfaqen virtytet e mira dhe të këqija, sepse ato dallojnë natyrat prej forcës, e forcat prej gjendjeve. E në udhëtim ka dëshira dhe ushqime të ndryshme. Ai që udhëton me njerëz serioz dhe autoritar e ngarkon veten me kulturë dhe përballje të shqetësimeve dhe pajtimin me ta në atë që e kundërshton natyrën e tij kështu që kjo është edukim për të dhe ushtrimi shpirtit. Me anë të kësaj ai edukohet e udhëzohet në largimin prej veseve të këqija dhe përfitimin e virtyeteve të mira. Ndërsa ai që udhëton me atë që është nën të, secili që është me të e ngarkon veten e tij të pajton me të dhe të përballoj vështirësitë për ta respektuar atë dhe në këtë mënyrë përmirësohet morali i tyre e ndoshta morali i tij përkeqësohet, ngase morali i mirë vërehet në përballimin e vështirësive.”²

Enesi (Allahu qoftë i kënaqur me të thotë):

“Dola me Xherir b. Abdil-lah në një udhëtim dhe ai më shërbente mua. E Xheriri ishte më i vjetër se Enesi.”³

Muxhahidi ka thënë:

“E kam shoqëruar Ibn Umerin që t’i shërbej atij megjithatë ai më shërbente mua.”⁴

E trembëdhjeta: Kthimi te familja pas kryerjes së nevojës së tij.

¹ El Xhami Li Ahlakirr Rravi ve Adabis Sami: 2/242.

² Fejdul Kadir: 4/82.

³ Buhariu me nr: 2822 dhe Muslimi me nr: 6380.

⁴ Ebu Asimi në kaptinën e Xhihadit me nr: 210 dhe Ibn Asakiri: 15/60.

Ebu Hurejre transmeton se Pejgamberi (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin për të) ka thënë:

“Udhëtimi është pjesë e dënimit. E pengon ndonjërin prej juve nga ushqimi, pija dhe gjumi. E kur ta kryen ndo njëri prej jush nevojën e tij le të shpejton për t’u kthyer te familja e tij.”¹

Pak më lart përmendëm sqarimin për këtë.

E katërbëdhjeta: Ta thotë lutjen e transmetuar para se të hyjë në fshat apo qytet.

E ajo është lutja që është transmetuar në hadithin e Suhejbit (Allahu qoftë i kënaqur me të) se Pejgamberi (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin për të) nuk e ka parë ndonjë vendbanim që ka dashtë të hyj në të e të mos ketë thënë:

“O Zoti im, Zoti i shtatë qiejve dhe atë që e kanë hijezuar, Zoti i shatë tokave dhe atë që ato e bartin, Zoti i djajve dhe atyre që ata kanë devijuar, Zoti i erërave dhe atë që ato bartin; Ne kërkojmë nga Ti të mirën e këtij vendbanimi dhe të mirën e banorëve të saj dhe kërkojmë mbrojtje te Ti nga e keqja e saj, e keqja e banorëve të saj dhe e keqja që është prezent në të.”²

E pesëmbëdhjeta: Të fillon me xhaminë kur të kthehet.

Kab b. Malik (Allahu qoftë i kënaqur me të) transmeton se nuk ka munguar nga asnjë betejë që e ka bërë i Dërguari i Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin për të) përveç se në betejën e Bedrit dhe të Tebukut, pastaj ka thënë:

“Vendosa të jem i sigurtë me Pejgamberin (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin për të) gjatë takimit paradite. Dhe rrallëherë vinte nga ndonjë udhëtim që e kishte bërë vetëm se paradite dhe fillonte me xhaminë së pari duke i falë dy rekate.”³

¹ Buhariu me nr: 2839 dhe Muslimi me nr: 1927.

² (Nesaiu në librin e tij “Amelul Jevm vel-lejleh” me nr: 367, Ibn Hibbani me nr: 2709 dhe e ka llogaritur të vërtetë si dhe Ibn Huzejme me nr: 2565 dhe Hakimi: 1/614. Ibn Haxheri e ka konsideruar të mirë sikur që e ka përmendur Ibn Al-lan në “El Futuhât”: 5/174.

³ Buhariu me nr: 4400.

Xhabir b. Abdil-lah (Allahu qoftë i kënaqur me të) thotë:
“Pejgamberi (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin për të) e bleu nga unë një deve dhe kur erdhi ne Medine më urdhëroi ë të shkoj te xhamia dhe të fal dy rekate.” (Buhariu me nr: 2923 dhe Muslimi me nr: 715).

E ky synet është prej syneteve të lëna pas dore ngase të pakët janë ata që e veprojnë në këtë kohë. Sikurse ky namaz të jetë falënderim për Allahun për arritjen e shëndoshë dhe ta fillon vendqëndrimin e tij me namazin i cili është lidhje mes tij dhe robit të tij. Ky synet si duket është i posaçëm për gratë e nëse gruaja i fal te shtëpia e saj dy rekate atëherë s’ka gjë.

E gjashtëmbëdhjeta: Të mos i trokasë familjes së tij natën.

Ens b. Maliku transmeton se i Dërguari i Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin për të):

“Nuk i vinte natën te familja e tij por ose vinte në mëngjes ose në mbrëmje.”

“Turuk”: Është ardhja natën nga udhëtimi apo diku tjetër në pakujdesinë e familjes së tij. I thuhet secilit që vjen natën “Tarik” dhe nuk i thuhet kështu atij që vjen ditën.²

Pejgamberi (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin për të) e ka treguar urtësinë e kësaj ndalese në hadithin që e transmeton Xhabir b. Abdil-lah (Allahu qoftë i kënaqur me të) ku thotë:

*“Ishim me Pejgamberin (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin për të) në një betejë dhe kur erdhëm afër Medines deshëm të hyjmë në të e ai tha: “Ngadalë derisa të futemi në mbrëmje që të bëhet gati ajo që nuk ka krehë flokët dhe të pastrohet nga papastërtitë ajo që nuk kishte burrin e saj prezent”.*³

Prej urtësive është edhe ajo që është transmetuar në një transmetim tjetër nga Xhabiri (Allahu qoftë i kënaqur me të) i cili

¹ Tra. Muslimi me nr: 1928.

² Fethul Bari: 9/340 dhe Sherhu Muslim: 13/71.

³ Muslimi me nr: 715.

thotë: *“Pejgamberi (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin për të) e ka ndalur që njeriu t’iu vjen familjes së tij natën duke i llogaritur si tradhtarë apo duke hulumtuar të metat e tyre.”*

Në këtë shekull janë mjetet e komunikimit kështu që udhëtari duhet ta lajmërojë familjen e tij me ardhjen para se të arrijë me një kohë të mjaftueshme dhe kjo është e posaçme për burrin. E Allahu e din më së miri.

¹ Muslimi me nr: 715.

Udhëtimi jashtë vendit

Jetojmë në këtë vend të begatshëm¹ në siguri, qetësi, rehati dhe stabilitet dhe për këtë falënderojmë Allahun.

Kjo fillimisht është me mirësinë e Allahut dhe së dyti për shkak të praktikimit të dispozitave të ligjit Islam duke zbatuar kështu urdhrin e Tij të lartësuar sa që rrallë mund të gjesh ndonjë të keqe publike dhe kjo për shkak të prezencës së burrave që urdhërojnë në të mirë dhe ndalojnë nga e keqja e të cilët janë të mbështetur nga udhëheqësit e këtij vendi.

Gjejmë shumë myslimanë nga lindja e deri në perëndim ku shpirtrat e tyre mallëngjehen për vizitën e këtij vendi dhe qëndrimin në të për shkak asaj që gjejnë prej të mirës në fenë dhe jetën e tyre por, megjithatë është për çudi që nuk kanë ndonjë hall tjetër vetëm se të udhëtojnë jashtë vendit, në vende drejt lindjes apo perëndimit ku pothuajse nuk gjen gjurmë të Islamit në to dhe qëndrimi atje për një muaj apo dy muaj jashtë vendit veçanërisht në vendet jo islame ka dëme të cilat janë të njohura për të gjithë. E do t'i përmendim disa nga to:

E para: Ekspozimi ndaj shumë dyshimeve në besim. Kjo me anë të metodës së paraqitjeve të shumë dyshimeve ndërsa dija e udhëtarit është e dobët dhe zakonisht ata pyesin pak kështu që kjo shkakton dyshimin njeriut në disa çështje të besimit islam.

¹ Arabinë Saudite. Pjesa e fundit e artikulli mund të ketë diç që mund të karakterizohet me Arabinë Saudite por, në përgjithësi është këshillë e vlefshme edhe për vendet e tjera dhe myslimanët anë e kënd botës.

E dyta: Shkuarja e disa udhëtarëve të fallxhorët, magjistarët, ..., lexuesit e shuplakave ku atje u lejohet veprimi edhe atë publikisht. E Pejgamberi (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin për të) ka thënë: *“Ai që shkon të ndonjë kahin (ai i cili tregon për të fshehtat në të ardhmen) dhe arraf (ai që tregon për të fshehta në të tashmen apo të kaluaren) dhe i beson në atë që thotë atëherë ka përgënjeshtuar atë me të cilën ka ardhur Muhamedi.”*²

Ibn Haxheri thotë:

“Këtij hadithi i dëshmon hadithi i Xhabirit, Imran b, Husajnit të cilët i ka transmetuar Bezari me dy senede të mirë.” nga disa gra të Pejgamberit (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin për të) i cili ka thënë:

*“Ai që shkon të fallxhori (Arrafi) dhe e pyet për ndonjë gjë nuk i pranohet atij namazi për dyzet ditë.”*³

E treta: Neglizhenca në kryerjen e namazit.

Besimtari është i fortë me vëllezërit e tij. Kurdo që largohet nga ata ndoshta dobësohet dhe bëhet neglizhent në kryerjen e obligimeve. Nga Ebu Derda (Allahu qoftë i kënaqur me të) transmetohet ka thënë: E ka dëgjuar të Dërguarin e Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin për të) duke thënë:

“Nuk janë tre persona në një fshat apo në një vendqëndrim qoftë në shkretëtirë dhe nuk kryhet namazi së bashku e që të mos i pushton

¹ Ahmedi me nr: 9532, Daremiu me numër: 1139, Ibn Maxheh me numrë: 639, nga hadithi i Ebu Hurejres dhe Hakimi: 1/49 i cili e konsideron të saktë.

² Fjala Kahin perdoret edhe si sinonim i fjalës Arraf dhe e kunderta. D.m.th çdokush që merret me këtë dhe mundohet të argumentohet për gjërat e fshehta nëpërmjet rrugëve të ndaluara dhe fallit hyn në kuptimin e këtyre dy nocioneve. Këta njerëz njihen te populli ynë si fallxhorë.

³ Muslimi me nr: 2230 dhe në Fethul Bari: 10/217.

shejtani. Prandaj përmbajuni xhematit ngase ujku e hanë prej deleve atë që largohet.”¹

E katërta: Lëshimi i shikimit dhe vështirësia e uljes së tij për shkak të përhapjes së zbulimit të femrave dhe avreteve.

Allahu thotë:

“Thuaju besimtarëve të ndalin shikimet (prej haramit), t'i ruajnë pjesët e turpshme të trupit të tyre se kjo është më e pastër për ta. All-llahu është i njohur hollësisht për atë që bëjnë ata. Thuaju edhe besimtareve të ndalin shikimet e tyre, t'i ruajnë pjesët e turpshme të trupit të tyre, të mos zbulojnë stolitë e tyre përveç atyre që janë të dukshme” (En Nur: 30-31)

Kurtubiu - Allahu e mëshiroftë – ka thënë:

”Ka filluar me uljen e shikimit para organit gjenital ngase shikimi është prijës i zemrës sikurse temperatura që i prijëse vdekjes.”²

Pejgamberi (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin për të) i ka thënë Aliut:

“Mos e paso shikimin me një shikim tjetër ngase ty të takon shikimi i parë por, jo edhe i dyti.”³

E në Sahihun e Muslimit transmetohet nga Xherir b. Abdil-lah (Allahu qoftë i kënaqur metë) se ka thënë:

“E ka pyetur të Dërguarin e Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin për të) për shikimin e befasishëm? E më ka urdhëruar ta largojë shikimin.”

¹ Ahmedi me nr: 21758, Ebu Davudi me nr: 547, Nesaiu me nr: 847, Ibn Hibbani me nr: 2101 dhe e ka llogaritur të saktë dhe ka thënë: Qëllimi me xhematin në hadith është xhemati për falje të namazit. Hadithin e ka konsideruar të mirë Neveviu në Rijadus Salihin: 1/209.

² Tefsirul Kurtubi: 12/227.

³ Ahmedi: 5/351, Ebu Davudi me nr: 2149, Tirmidhiu me nr: 2777 nga hadithi i Burejdes si dhe Hakimi: 2/212 dhe e ka konsideruar të saktë e Tirmidhiu ka thënë: Hadith Hasen Garib.

E pesta: Toleranca e disa udhëtarëve me hyrjen në salla vallëzimi dhe klube të natës në të cilat i bëhet mëkat të Gjithëmëshirshmit dhe serohen në to alkooli dhe vallëzimit të vajzave të bukura.

Umer b. Hattabi (Allahu qoftë i kënaqur me të) se ka thënë:
“O ju njerëz e kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin për të) duke thënë: “Ai që beson Allahun dhe Ditën e Gjykimit mos të ulet në tavolinën në të cilën serohet alkooli.”¹

E gjashta: Lehtësia e posedimit të drogës veçanërisht kur dihet se disa shtete e lejojnë shitjen e saj në vende të posaçme dhe në këtë ka dëme jashtëzakonisht të mëdha.

Dhe dëme të tjera të cilat janë të njohura për të gjithë. E në vendin tonë – e falënderojmë Allahun – kemi dy vendet më të pastra në gjithë rruzullin tokësor, Mekën dhe Medinën. Gjithashtu në të ka vende të bukura, të ftohta ka dalje në dete të ndryshme dhe zall e të gjitha këto të mjaftojnë nga udhëtimi jashtë vendit.

Dijetari Ibn Utthejmin – Allahu e mëshiroftë – e ka përmendur se për daljen jashtë vendit kushtëzohen disa kushte:

- 1) Udhëtari duhet të ketë dije me anë të së cilës i zmbraps dyshimet.
- 2) Duhet të ketë devotshmëri me anë të së cilës i largon epshet.
- 3) Duhet të ketë nevojë për këtë.
- 4) Përkujdesja për kryerjen e obligimeve fetare

¹ Ahmedi me nr: 125, Ebu Jala me nr: 251 me send të dobët dhe e ka transmetuar Tirmidhiu e Hakimi prej transmetimit të Xhabirit për të cilin thotë Tirmidhiu: Hasen Garib. E Hakimi thotë: Hadith i vërtetë i plotëson kushtet e Buhariut dhe Muslimit. Hadithin e konsideron të vërtetë Shejh Albani në librin e tij “El Irva” me nr: 1949.

Allahun e falënderojmë dhe dërgojmë salavatet tona për peygamberin tonë, Muhamedin, familjen dhe të gjithë shokët e tij.